



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:037751

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05564241

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.K., nga Gjakova, për shkak të veprës penale **uzurpim i paligjshëm i pronës se palujatshem ne vazhdimësi nga neni 320/1 -31 të KPRK-ës**, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore - Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë PP/II.nr. 72/22 të dt.23.02.2022, në bazë të nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së si dhe nenit 11 të Ligjit Mbi Ndërmjetësimin 06/nr.L-009, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me datës 11.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim e lidhur në mes të akuzuarit S.K., me nr. personal 1173852807, dhe të dëmtuarit K.K., nga Gjakova, me nr. personaleqë të dy nga Gjakova, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjakovë, Nd.nr.2022:037751 e datës 02.04.2024.

II.HUDHET aktakuza e Prokuroria Themelore - Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë PP/II.nr. 72/22 të dt.23.02.2022, dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të akuzuarit S.K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale **uzurpim i paligjshëm i pronës se palujatshem ne vazhdimësi nga neni 320/1 -31 të KPRK-ës**

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - Departamenti Përgjithshëm në Gjakovë PP/II. nr. 72/22 të dt.23.02.2022, kundër të akuzuarit S.K., , për shkak të veprës penale **uzurpim i paligjshëm i pronës se palujatshem ne vazhdimësi nga neni 320/1 -31 të KPRK-ës**

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale dhe se pas njoftimit të dëmtuarit se me të akuzuarit kanë arritur marrëveshje dhe janë pajtuar për këtë çështje penale, Prokurori i shtetit nuk e ka kundërshtuar vetë iniciimin e palëve që të shkojnë në procedurën e ndërmjetësimit, ku palët si i akuzuari dhe të dëmtuari janë pajtuar, gjyqtari e ka ndërprerë seancën dhe i ka udhëzuar palët se këtë çështje mund ta zgjedhin edhe me ndërmjetësim.

Me datën 02.04.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjakovë, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarit S.K.,dhe të dëmtarit K.K.,

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes për ndërmjetësim.

Qendra për Ndërmjetësim me vendim Nd.nr.2022:037751 të datës 02.04.2024, ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së dhe nenit 11 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin 06/nr.L-009 të dt. 23 korrik 2018, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.2022:037751 datë 11.04.2024

Sekretarja juridike
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.